



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa: rr. "Adem Jashari" pn, kk.rks-gov.net/gjilan, info.gjilan@rks-gov.net tel. 0280 320 781, 0280 320 782, 321 482, 321 483.

Në bazë të nenit 24. të Ligjit për Planifikim të Hapsirës nr. 2003/14, nenit 4. par.3. të Ligjit për ndryshimin e LPH, nr. 03/L-106, Udhëzimit Administrativ për zbatimin e Ligjit për planifikimin hapësiror mbi elementet e themelore të Planit Rregullues Urban, nr. rend. 41, nr. prot.02/05, nenit 38.1. (b,c,d.) të dhe nenit 81. (h.i.) të Statutit të Komunës së Gjilanit, e në vështrim të nenit 6 të Vendimit për miratimin e Planit Zhvillim Urban të Qytetit të Gjilanit, nr.01-11735, dt. 30.10.2008, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më datë: 29.06.2012, miraton këtë:

V E N D I M

Për miratimin e Zgjidhjes Urbanistike hapësirës publike "Parku", në Lagjen "Arbëria"

Neni 1

Me këtë Vendim miratohet Zgjidhja Urbanistike e hapësirës publike e në lagjen "Arbëria" e cila në anën e majtë të rrugës lokale Gjilan - Preshevë dhe ate: parcela nr.1880-0, në sipërfaqe prej: 25249m², në tërësi sipas paraqitjes grafike në kopje të planit Ortofoto dhe Projektit Zbatues të cilat janë pjesë përbërse e këtij vendimi.

Neni 2

Me Zgjidhjen Urbanistike nga pika 1. e këtij vendimi janë harmonizuar zhvillimet e bëra, gjatë periudhës paraprake dhe janë përshtatur nevojat dhe mundësitë reale për të arritur kushte optimale të zhvillimit, organizimit, rregullimit të hapësirës, ndërtimit dhe shfrytëzimit racional të objekteve të infrastrukturës teknike komunale, me qëllim të krijimit të kushteve për qarkullim të lirë dhe të papenguar dhe siguri për nxënësit dhe pjesëmarrsit tjerë në komunikacion.

Neni 3

Zgjidhja Urbanistike nga pika 1. e këtij Vendimi, është hartuar nga Ndërmarrja Shërbyese "E design" nga Prishtina, dhe e njëta nënkupton caktimin e kushteve të lokacionit për ndërtimin e objekteve të Infrastrukturës teknike komunale (rrugëve, aleve, shtigjeve për këmbësor, hapësirave të gjelbërta dhe hapësirave për sport dhe rekreacion, rrjeteve të ujësjellësit, kanalizimit dhe rrjetit të përvojave tjera, në tërësi sipas Projektit Zbatues të hartuar nga po e njëjta kompani.

Neni 4

Obligohet Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit e Komunës së Gjilanit, që kushtet e lokacionit nga zgjidhja Urbanistike të inkorporojë në Planin Rregullues Urban të lokacionit në fjalë.

Neni 5

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës së Gjilanit, Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit e KK-ës Gjilan, si dhe Drejtoria për Gjoedezi, Kadastër dhe Pronë e KK-ës Gjilan

Neni 6

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

Neni 7

Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, pushon të vlej Plani Detaj Urbanistik; Arbëria 1 nga viti 1984, dhe aktet tjera që burojnë nga ai Plan, për hapësirën e përfshirë në pikën 2. të këtij Vendimi.